



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr.Prot.916/20; Datë: 12.03.2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 17 të Statutit të Përkohshëm të UShAF, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 12.03.2020, nxjerr:

VENDIM

1. Deri në përfundimin e periudhës së pezullimit të procesit mësimor të caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të gjitha aktivitetet e zgjedhjeve studentore do të zhvendosen për aq ditë sa do të zgjasë pezullimi.
2. Shtyerja e aktiviteteve të dinamikës zgjedhore, për aq ditë sa do të zgjasë pezullimi i procesit mësimor i caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës do të zbatohet edhe për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjen e Rektorit në UShAF.
3. Këshilli Drejtues autorizon KQZ-në që të zbatojë një dinamikë të re zgjedhore duke pasur parasysh numrin e ditëve sa do të zgjasë pezullimi i procesit mësimor i caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe numrin e ditëve për të cilat është zbatuar dinamika e miratuar nga KQZ-ja pas shpalljes së zgjedhjeve nga Këshilli Drejtues, sipas vendimit nr. prot: 759/20, datë: 02.03.2020.
4. Pas përfundimit të pezullimit të procesit mësimor të caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, KQZ do të njoftoj Këshillin Drejtues për fillimin e zbatimit të dinamikës nga aty ku ka mbetur.
5. Në rast se Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendim tjetër lidhur me fillimin ose shtyrjen e procesit mësimor, UShAF do të veproj konform vendimit të ri të Qeverisë me ç'rast autorizohet KQZ që të përpiloj dinamikën e re të zgjedhjeve.
6. Moszbatimi i këtij vendimi sanksionohet sipas nenit 250 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi nga dita e marrjes së tij.

S.O.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UShAF-it menjëherë pas shpalljes së COVID-19, si pandemi globale nga Organizata Botërore e Shëndetit, si dhe vendimit të datës 11.03.2020, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për pezullim të procesit mësimor nga data 12 mars 2020 deri më 27 mars 2020, me qëllim të shmangies nga çfarëdo rreziku për shëndetin e studentëve, personelit dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UShAF-it;
2. Njësive akademike të UShAF-it;
3. Sekretarit të UShAF-it;
4. Menaxhmentit të UShAF-it;
5. KQZ-së dhe
6. Për publikim në ueb-faqe të UShAF-it.

Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Kryesues i Këshillit Drejtues

